



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.759/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit "Eglo Kosova" LLC me NUI: ..., me seli në ..., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit A.A avokat nga ...i ..., kundër debitorit "Lakeside AG" me NUI: ..., me seli në ..., ..., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.1006/2021 të datës 28.10.2021, i Përmbartuesit Privat E.H me seli në ..., jashtë seancës me datën 17.05.2023, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit "Lakeside AG", i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.1006/2021 të datës 28.10.2021 i Përmbartuesit Privat E.H.
- MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.1006/2021 të datës 28.10.2021, i Përmbartuesit Privat E.H.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.1006/2021 të datës 28.10.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumenteve të besueshme – Faturave nr: 3055 e datës 03.08.2020, nr.2445 e datës 29.06.2020, nr.1895 e datës 04.06.2020, nr.1832 e datës 30.05.2020, nr.1814 e datës 30.05.2020, nr.1668 e datës 22.05.2020, nr.1202 e datës 09.04.2020, nr.1146 e datës 03.04.2020 dhe nr.2481 e datës 30.06.2020, ku e ka urdhëruar debitorin që pas pranimit të këtij urdhri t'ia paguaj borxhin total kreditorit në shumë prej 8,623.75 euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së propozimit për përmbartim e deri në ditën e pagesës definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014 dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim në të cilin ka deklaruar se nuk qëndron borxhi i përshkruar në propozimin e përmbarimit sepse kreditori ende nuk i ka kryer të gjitha obligimet e veta e po ashtu ende nuk është bërë pranim dorëzimi i punëve të kryera nga kjo kompani dhe se palët janë marrë vesh ndryshe për barazimin e obligimeve duke ditur se kanë pasur bashkëpunim të madh. Më tutje, ka shtuar se faturat nuk janë të rregullta dhe nuk janë të pranuar nga debitori, por dyshojmë se ato janë fiktive dhe nënshkrimet janë krejt të ndryshme nga secila faturë me rastin e pranimit sipas kreditorit dhe se debitori ka vulë pranimi dhe ka personin përgjegjës për të nënshkruar secilin obligim të debitorit. Andaj i ka propozuar Gjykatës që prapësimi të aprovohet si i bazuar dhe të anulohet Urdhri për Përmbarim P.nr.1006/2021 i datës 28.10.2021.

Kreditori, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara për arsye se nuk qëndron fakti se kreditori nuk i ka kryer obligimet e tij dhe nuk ceket qartë se çfarë obligime duhet të përmbushen dhe se dorëzimi i mallit është bërë në momentin e pranimit në mënyrë të rregullt të faturave që dëshmohet edhe me nënshkrim dhe vulë të debitorit dhe se ka paguar pjesërisht detyrimin e tij, andaj faturat sipas nenit 29 par.3 të LPP-së janë të përshtatshme për përmbarim. Duke u bazuar në të lartcekurat i propozon Gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar dhe Urdhri P.nr.1006/2021 i datës 28.10.2021, të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Debitori nuk ka ofruar asnjë provë me shkrim siç parashihet me nenin 69 paragrafi 4 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilit: *“Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*, me të cilën do të mund të argumentonte pretendimet e cekura në prapësim apo se ekziston ndonjëri nga shkaqet e përcaktuara në nenin 71 të LPP-së, në të cilat bazohet prapësimi i palës.

Gjykata vlerësoi se urdhri P.nr.1006/2021 i datës 08.10.2021, i Përmbauesit Privat E.H, është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përmbaimore për shkak se në këtë rast Përmbauesi Privat e ka lejuar përmbaimin në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturave, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbaimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbaim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbaim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbaimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata konstaton se në këtë çështje përmbaimore urdhri i lejuar nga ana e përmbauesit privat bazohet në dokumentet e besueshme përkatësisht faturat: 3055 e datës 03.08.2020, nr.2445 e datës 29.06.2020, nr.1895 e datës 04.06.2020, nr.1832 e datës 30.05.2020, nr.1814 e datës 30.05.2020, nr.1668 e datës 22.05.2020, nr.1202 e datës 09.04.2020, nr.1146 e datës 03.04.2020 dhe nr.2481 e datës 30.06.2020, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par.3 të LPP-së, ngase në to janë treguar palët përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përcaktuara mallrat/shërbimet të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave dhe shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Në rastin konkret rezulton se faturat janë dorëzuar në origjinal nga ana e kreditorit dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, gjë e cila vërtetohet edhe nga nënshkrimi dhe vula e debitorit.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbaimore, vlerëson se urdhri për përmbaim i lejuar mbi bazën e dokumenteve të besueshme nuk është në kundërshtim me dispozitën e nenit 29 të LPP-së, ngase nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbaimit siç përcaktohet në nenin 71 të LPP-së.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera te debitorit të paraqitur në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbare.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, bazuar në nenin 73 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

KPPP.nr.759/22, datë 17.05.2023

Gjyqtari  
Gent Bekeri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.